



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 184, Datë 06.07.2026

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “NEXORA ENERGY” SH.P.K. PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e” dhe 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1660/7 prot., datë 03.07.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “NEXORA ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “NEXORA ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1660 prot., datë 22.05.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Pas verifikimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 160, datë 05.06.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- Në zbatim të kërkesave të Rregullores së Licencimit, ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 06.06.2026 dhe 08.06.2026). Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Brenda afatit të përcaktuar nuk u administruan komente apo kundërshtime nga palët e interesuara, të cilat të kërkonin kryerjen e verifikimeve shtesë apo të ndikonin në vijimin e procedurës administrative.
- ERE, me shkresën nr. 1660/3 prot., datë 10.06.2026, i njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për licencimin e saj si dhe i ka bërë me dije se në rast licencimi, do t’ i lihet kushti përkatës në lidhje me përditësimin e informacionit mbi stafin teknik.
- Në vijim të procedurës, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1660/4 prot., datë 22.06.2026, shoqëria ka depozituar informacion plotësues, nga shqyrtimi i të cilit është vlerësuar i nevojshëm zhvillimi i komunikimit të mëtejshëm. Ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1660/5 prot., datë 24.06.2026 në lidhje me sqarimet përkatëse për stafin

technik që do të ushtrojë veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1660/6 prot., datë 30.06.2026, shoqëria depozitoi informacionin e kërkuar duke plotësuar dokumentacionin administrativ të nevojshëm për përfundimin e shqyrtimit të aplikimit.
- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

Përputhshmëria e aplikimit me kuadrin ligjor dhe rregullator

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës administrative rezulton se kërkesa e shoqërisë **"NEXORA ENERGY" sh.p.k.** për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike është paraqitur në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe me kërkesat e **Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike**, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Në përfundim të shqyrtimit administrativ rezulton se shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, ndërsa gjatë procedurës është informuar edhe për dokumentacionin dhe sqarimet shtesë të kërkuara nga ERE, duke plotësuar dosjen e aplikimit në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- Rezulton gjithashtu se aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit në përputhje me kërkesat e Rregullores së Licencimit dhe nuk rezultojnë detyrime financiare ndaj Entit Rregullator të Energjisë që të përbëjnë pengesë për përfundimin e procedurës së licencimit.
- Po ashtu, në përfundim të procedurës së njoftimit publik për fillimin e procedurës administrative nuk u administruan komente, kundërshtime apo pretendime nga palë të treta, të cilat të kërkonin verifikime të mëtejshme ose të ndikonin në shqyrtimin e kërkesës.
- Për sa më sipër, nga analiza e dokumentacionit të administruar nuk rezultojnë pengesa ligjore apo procedurale që të ndalojnë licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë **"NEXORA ENERGY"** sh.p.k. për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “NEXORA ENERGY” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI